



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 71/2021 (JR)
Nr. 71/8 regj.

Tiranë, më 28.05.2024

SHPALLJE
E

NJOFTIMIT PËR ZHVILLIMIN E GJYKIMIT TË ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet e procesit, si dhe të gjithë personat e interesuar, se më datë 28.05.2024, trupi gjykues gjatë shqyrtimit mbi bazë aktesh në dhomë këshillimi, të çështjes me numër regjistri (JR) 71/2021, datë 17.11.2021, mbi ankimin e subjektit të rivlerësimit Sali Hasa, kundër vendimit nr. 433, datë 03.09.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 51, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, vendosi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e subjektit të rivlerësimit, pasi çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për konstatimin e plotë të situatës faktike.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në datën **12.06.2024 ora 10.00**, në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykues përbëhet nga gjyqtarët:


Kryesues i Trupit Gjykues
Relatore e Çështjes
Gjyqtare
Gjyqtare
Gjyqtare

Albana Shtylla
Natasha Mulaj
Ina Rama
Rezarta Schuetz
Sokol Çomo

Bazuar në nenin 460, pika 5 e Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 51, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, kjo shpallje bëhet të paktën 10 ditë para seancës gjyqësore, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe atë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit.



KRYESUES I TRUPIT GJYKUES
GJYQTAR


ALBANA SHTYLLA

